# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6120
E martë, 22 shtator 2020
çmimi 0.40


## Dosjet e Speciales? FAQE 7



Shkruan: Hysni GUCATI

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


NË KOSOVË TË HËNËN KA QËNDRUAR NJË DELEGACION I QEVERISË AMERIKANE I KRYESUAR NGA ADAM BOEHLER, KRYESHEF EKZEKUTIV I KOORPORATËS NDËRKOMBËTARE TË FINANCAVE DHE ZHVILLIMIT NË SHBA (DFC), I CILI ISHTE I SHOQËRUAR EDHE NGA I DËRGUARI I POSAÇËM I SHTËPISË SË BARDHË PËR DIALOGUN, RICHARD GRENELL FAQE 2

# SHBA-ja DHE KOSOVA ZOTOHEN PËR ZBATIM TË SHPEJTË TË MARRËVESHJES SË UASHINGTONIT

## ShBA-ja do të investojë 100 milionë dollarë në Kosovë



FLET PËR "EPOKËN E RE", ZAFIR BERISHA FAQE 4-5

# RRETHANAT POLITIKE KËRKOJNË NJË QEVERI MË STABILE



Anëtari i kryesisë së Nismës Socialdemokrate, njëherësh zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Zafir Berisha, ka vlerësuar se Kosovës i duhet një qeveri më stabile. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se rrethanat politike në të cilat gjendet vendi kërkojnë një qeveri me më shumë numra dhe ide. Sipas Berishës, një gjë të tillë e bën të nevojshme edhe faza finale e dialogut me Serbinë. Ai ka folur edhe për funksionin e koalicionit aktual qeverisës, duke thënë se ky koalicion nuk është në nivelin e duhur

## OPINION

### PSE PO VJEN GRENELLI PËRSËRI NË BALLKAN? F. 11

Shkruan: Faton ABDULLAHU



## AKTUALE



### IKSHPK-ja: GJATË DY JAVËVE TË FUNDIT KA RËNIE TË NUMRIT TË RASTEVE ME COVID-19 F. 7

### HUNGARIA VLERËSON SE KOSOVA I KA PËRMBUSHUR TË GJITHA OBLIGIMET PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE F. 6

### PËRUROHET SHTATORJA E KOLONEL AHMET KRASNIQIT F. 6

## EKONOMI

### 105 DEPUTETË TË VITEVE '90 DO TË PËRFITOJNË NGA 2 733 EURO F. 8

### KOSOVA DHE JAPONIA DO TË MBAJNË KONFERENCË TË PËRBASHKËT EKONOMIKE F. 8

## SPORT

### ZEKOLLI: LIGA UNIKE DO T'I RRITË VLERAT DHE KONKURRENCËN NË BASKETBOLLIN SHQIPTAR 12


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhep isht Tetov°
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 0 +389 44 487 7
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
ND RTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOV,
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin°, Kosov°,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Në Kosovë të hënën ka qëndruar një delegacion i qeverisë amerikane i kryesuar nga Adam Boehler, kryeshef ekzekutiv i Koorporatës Ndërkombëtare të Financave dhe Zhvillimit në ShBA (DFC), i cili ishte i shoqëruar edhe nga i dërguari i posacëm i Shtëpisë së Bardhë për dialogun, Richard Grenell

# ShBA-ja dhe Kosova zotohen për zbatim të shpejtë të marrëveshjes së Uashingtonit

## ShBA-ja do të investojë 100 milionë dollarë në Kosovë



Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, dhe kryeshefi ekzekutiv i Koorporatës Ndërkombëtare të Financave dhe Zhvillimit në ShBA, Adam Boehler, kanë nënshkruar një deklaratë të përbashkët, përmes së cilës mirëpresin "përfundimin e shpejtë të një marrëveshjeje për nxitjen e investimeve Kosovë-ShBA". Deklarata u nënshkrua në Qeverinë e Kosovës në praninë e presidentit Hashim Thaci dhe të dërguarit të posacëm të Shtëpisë së Bardhë për dialogun, Richard Grenell

**Prishtinë, 21 shtator (ER)**- Kosova dhe Shtetet e Bashkuara kanë nënshkruar një deklaratë të përbashkët, përmes së cilës mirëpresin dhe zotohen për përshpejtim të përfundimit të proceseve të brendshme, për zbatimin e marrëveshjes së 4 shtatorit. Këtu përfshihet, Marrëveshja për stimulim të investimeve amerikane.

Deklarata u nënshkrua në Qeverinë e Kosovës nga kryeministri kosovar Avdullah Hoti dhe Adam Boehler, kryeshef ekzekutiv i Koorporatës Ndërkombëtare të Financave dhe Zhvillimit në ShBA (DFC), në praninë e presidentit Hashim Thaçi, dhe të dërguarit të posaçëm të Shtëpisë së Bardhë për dialogun, presidencial Richard Grenell. "Marrëveshja që kemi nënshkruar sot ka qenë zotim për të përshpejtuar investimet në Kosovë. Ne kemi qenë duke punuar në përgatitjet për mundësitë e asaj që ndodhi disa javë më parë. Kemi punuar me ambasadën tonë, me ambasadorin tonë dhe kemi projekte në vlerë deri në 1 miliard dollarë. Aty përfshihet Autostrada e Paqes, hekurudha, gazi natyror. Kemi biseduar edhe për mundësinë e investimit në një resort të skijimit. Po ashtu, mbështetje direkte për bizneset e vogla dhe të mesme", ka sqaruar Boehler, duke theksuar se do të investojnë 100 milionë dollarë në Kosovë.

Pjesë e delegacionit të qeverisë amerikane i cili po qëndron në Prishtinë ishte edhe i dërguari i posaçëm i Shtëpisë së Bardhë për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell.

Ai tha se "popullit të Kosovës i janë bërë shumë premtime dhe ajo që ne po mundohemi të bëjmë është të bëjmë premtimin se zbatimi i marrëveshjes është ajo që do të ndodhë". "Ne shpresojmë se zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës do të ndryshojë pejsazhin politik të rajonit. Presidenti Trump me tha shko dhe arrije një marrëveshje që bazohet në krijimin e vendeve të punës", ka deklaruar Grenell.

Ai ka theksuar se në muajt e ardhshëm, nga Shtetet e Bashkuara, do të vijë një ekip për të krijuar dy studime fizibiliteti për krijimin e vendeve të punës.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, konfirmoi se ministrat e kabinetit qeveritar do të formojnë ekipe të veçanta, të cilat do të dakordohen me ekipet e ShBA-së për zbatimin e projekteve që dalin nga marrëveshja e 4 shtatorit. "Ky është një momentum i ri që do të sjell zhvillim ekonomik, jo vetëm për Kosovën por për tërë rajonin. Do të lëvizim shpejtë në zbatimin e kësaj marrëveshje dhe shpresojmë të arrijmë së shpejti edhe marrëveshjen politike", ka deklaruar Hoti, duke shtuar se nuk e di se kur mund të arrihet kjo e fundit. Hoti u shpreh i bindur se me këto projekte do të hapen mijëra vende të reja pune.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje shënon nisjen në praktikë të zbatimit të asaj çfarë u nënshkrua në më pak se tri javë më parë nga liderët e Kosovës dhe Serbisë me presidentin e SHBA-së, Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, për normalizim ekonomik. Delegacioni 14 anëtarësh i administratës amerikane u udhëhoq nga Adam Boehler, kryeshef ekzekutiv i Korporatës Ndërkombëtare të Financave dhe Zhvillimit në SHBA (DFC). Boehler së bashku me udhëheqësen e Bankës për Eksport-Import, Kimberly Reed, më 15 shtator kanë nënshkruar letrat e interesit me Kosovën dhe Serbinë, përmes së cilave do të ndihmojnë në financimin e Autostradës së Paqes.

DFC pritet që bashkë me Bankën amerikane për Eksport-Import të ndihmojnë në financimin e Autostradës së Paqes, që do të lidhë Nishin me Prishtinën.

Para fillimit të ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjes, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi i ka ndarë Medaljen presidenciale të Meritave, të dërguarit të Shtëpisë së Bardhë për dialogun, Richard Grenell, për "meritat e tij të veçanta në arritjen e marrëveshjes historike mes Kosovës dhe Serbisë, të nënshkruar në Uashington".

Në marrëveshjen e nënshkruar më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë, është arritur pajtueshmëri që Kosova dhe Serbia, do të punojnë me Korporatën Ndërkombëtare të SHBA-së për Zhvillim Financiar dhe EXIM, në memorandumet e mirëkuptimit, për të operacionalizuar Autostradën e Paqes, lidhjen hekurudhore Prishtinë-Merdare, lidhjen hekurudhore Nish-Prishtinë, sigurimin e financave për mbështetjen e kredive që kërkohen për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, projekte shtesë dypalëshe dhe prani e plotë ndërkombëtare në Beograd, e DFC-së.

Të hënën në mbrëmje, delegacioni amerikan është nisur për në kryeqytetin serb, Beograd, ku të martën pritet të hapë zyrën e saj DFC-ja amerikane.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# IKShPK-ja: Gjatë dy javëve të fundit ka rënie të numrit të rasteve me Covid-19

Në Kosovë gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar edhe dy raste të vdekjes nga Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar të hënën se nga 596 mostra të testuara, pozitivë me Covid kanë dalë 79 pacientë. IKShPK-ja ka theksuar se gjatë dy javëve të fundit ka rënie të dukshme të numrit të rasteve



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 21 shtator** - Situata epidemiologjike me Covid-19 paraqitet stabile, me tendencë të rënies ne javët në vazhdim, si rezultat i zbatimit të rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Gjatë dy javëve të fundit ka rënie të dukshme të numrit të rasteve, 44 për qind. Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 596 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 79 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar dy raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv (1 rast nga Klinika e Pulmologjisë, QKUK dhe 1 rast nga Spitali rajonal Pejë).

Numri total i rasteve pozitive është 15 142 raste nga 62 607 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 615 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 104 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 12 674 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 853.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 23 raste, komuna Vushtrri 9 raste, komuna Gjakovë 8 raste, komuna Gjilan 7 raste, komuna Lipjan 5 raste, komuna Deçan 3 raste, komuna Fushë Kosovë 3 raste, komuna Kaçanik 3 raste, komuna Mitrovicë 3 raste, komuna Prizren 3 raste, komuna Viti 3 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Pejë 2 raste dhe me nga një rast komunat Ferizaj, Malishevë, Podujevë, Skenderaj dhe Suharekë.

# Ministri Kuçi pret në takim shoqërinë civile dhe banorët e Deçanit për çështjen e hidrocentraleve




Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, gjatë takimit me përfaqësuesit e disa organizatave të shoqërisë civile dhe banorët e zonës së Deçanit, ka thënë se çështja e hidrocentraleve në Deçan nuk ka filluar as sot e as dje, por shumë më herët. "Tash jemi përballë një procesi që kërkon një zgjidhje të drejtë. Ajo që mund të them është se monitorimi dhe kontrolli duhet të jetë më i rreptë", ka thënë ministri Kuçi

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 21 shtator** - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka pritur të hënën në një takim përfaqësuesit e disa organizatave të shoqërisë civile dhe banorët e zonës së Deçanit. Ky delegacion paraqiti para ministrit Kuçi shqetësimet e tyre në lidhje me punimet dhe gjendjen që është krijuar në Grykë të Deçanit si pasojë e ndërtimit të hidrocentraleve.

Ministri Blerim Kuçi ka dëgjuar të gjitha shqetësimet dhe kërkesat, duke iu premtuar që gjithçka që është në kundërshtim me ligjin nuk do të lejohet të ndodhë. Për këtë ai falënderoi edhe këtë grup për angazhimin e tyre, duke treguar se ka nevojë për monitorim më të rreptë në këtë fushë. "Shqetësimi juaj është i qartë, sikur jam i qartë edhe unë me atë se do ta zbatoj ligjin në secilin hap. Çështja e hidrocentraleve në Deçan nuk ka filluar as sot e as dje, por shumë më herët. Tash jemi përball një procesi që kërkon një zgjidhje të drejtë. Ajo që mund të them është se monitorimi dhe kontrolli duhet të jetë më i rreptë", ka thënë ministri Kuçi.

Të gjitha kërkesat e këtij delegacioni janë evidentuar nga kabineti i ministrit dhe është dorëzuar kërkesa e shkruar që do ta marrë vëmendjen e duhur. Kërkesë e ministrit Kuçi ndaj këtij grupi ishte që mos të reshtin së ngrituri zërin kur shohin se po shkelet ligji dhe të drejtat. "Zëri i arsyeshëm i banorëve dhe shoqërisë civile me kërkesa të realizueshme dhe përkushtimi i institucioneve janë mjetet që na dërgojnë në hapa të sigurt. Gjithmonë do të jem i hapur për shoqërinë civile, pasi ata shohin pak më thellë se sipërfaqësisht. Kjo më duhet edhe mua si ministër në një dikaster që ka shumë punë dhe shumë të kaluara", ka thënë ministri Kuçi.

Pjesë e takimit ishte edhe zëvendësministri Muharrem Nitaj dhe drejtorët e dikastereve përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.



FLET PËR "EPOKËN E RE", ZAFIR BERISHA

# RRETHANAT POLITIKE KËRKOJNË NJË QEVERI MË STABILE

Anëtari i kryesisë së Nismës Socialdemokrate, njëherësh zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Zafir Berisha, ka vlerësuar se Kosovës i duhet një qeveri më stabile. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se rrethanat politike në të cilat gjendet vendi kërkojnë një qeveri me më shumë numra dhe ide. Sipas Berishës, një gjë të tillë e bën të nevojshme edhe faza finale e dialogut me Serbinë. Ai ka folur edhe për funksionin e koalicionit aktual qeverisës, duke thënë se ky koalicion nuk është në nivelin e duhur

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 21 shtator** - Anëtari i kryesisë së Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka bërë me dije se Kosovës i duhet një qeveri më stabile. Ai ka thënë se një qeveri të tillë e bëjnë të nevojshme rrethanat politike dhe të sigurisë në të cilën ndodhet Kosova. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Berisha ka deklaruar se kjo nuk duhet të ndodhë sepse qeveria aktuale është jostabile. "Besoj se në situatën politike në të cilën gjendet Kosova, kërkohet një qeveri më stabile, pra edhe në kuptimin e numrave, ideve dhe vizioneve që kanë subjektet politike. Rrethanat në të cilat gjendet Kosova, zhvillimet politike dhe të sigurisë rreth Kosovës e bëjnë të nevojshme krijimin e një stabiliteti më të madh qeverisës. Kjo duhet të ndodhë jo pse kjo qeveri nuk ka stabilitet, por për shkaqe të tjera", ka thënë Berisha. Sipas tij, një ndër arsyet është edhe faza përfundimtare e dialogut me Serbinë. "Tani jemi në momente përfundimtare të zgjidhjes së problemit me Serbinë, i cili e ka përcjellë çdo qeveri pas zgjedhjeve në këto 20 vjet. Prandaj, duke i parë këto zhvillime, qeveria aktuale duhet të forcohet në mënyrë që disa problemeve një herë e përgjithmonë t'u japë fund", ka deklaruar ai.

Berisha ka folur edhe për funksionimin e koalicionit aktual qeverisës. Sipas tij, ky koalicion nuk është në nivelin e duhur. "Sido që të jetë, koalicioni qeverisës ndoshta nuk është në nivelin e duhur, por ja që ky është realiteti në Kosovës tash e sa vite. Funksionimi i koalicionit është çështje e nivelit të liderëve politikë", ka vlerësuar ai.

Duke mos dashur t'i komentojë përplasjet në mes të LDK-së dhe AAK-së, Berisha ka thënë se Nisma në këtë koalicion është duke u sjell në përputhje me përgjegjësitë që ka marrë. "Mund të them me përgjegjësi se Nisma Socialdemokrate me hapësirën që ka brenda qeverisë është në përputhje me përgjegjësitë politike dhe konform besueshmërisë që ka marrë në zgjedhjet e fundit. Përndryshe, përplasjet midis



subjekteve politike kur ato bëhen për të mirën e qeverisë dhe të vendit, natyrisht se reflektojnë dhe krijojnë pozitivitet", ka thënë Berisha.

Berisha, i cili ushtron edhe detyrën e zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, gjendjen e sigurisë në vend e ka vlerësuar të mirë. "Mendoj se niveli i sigurisë në vend është aty ku duhet të jetë për arsye se një pjesë të kompetencave të sigurisë i kanë mekanizmat ndërkombëtarë si KFOR-i. Por, në përputhje me mandatin ligjor që ka Ministria e Punëve të Brendshme, gjendja e sigurisë është në nivelin e duhur. Kur marrim statistika nga vendet e tjera të rajonit, llogarisim se në aspektin e sigurisë Kosova është në nivelin e duhur", ka deklaruar Berisha.

**"Epoka e re":** *Z. Berisha, ju jeni pjesë e qeverisë Hoti. Si po e shihni funksionimin e këtij koalicioni qeverisës?*

**Berisha:** Unë më tepër jam i përqendruar në angazhimin profesional, pra në përgjegjësitë politike në fushën e sigurisë që kam në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Sido që të jetë, koalicioni qeverisës ndoshta nuk është në nivelin e duhur, por ja që ky është realiteti në Kosovë tash e sa vite. Funksionimi i koalicionit është çështje e nivelit të liderëve politikë.

**"Epoka e re":** *Kemi parë se shpeshherë ka mospajtime të partnerëve të koalicionit qeverisës. Këto mospajtime e dëmtojnë funksionimin e koalicionit qeverisës?*

**Berisha:** Mund të them me përgjegjësi se Nisma Socialdemokrate me hapësirën që ka brenda qeverisë është në përputhje me përgjegjësitë politike dhe konform besueshmërisë që ka marrë në zgjedhjet e fundit. Përndryshe, përplasjet midis subjekteve politike kur ato bëhen për të mirën e qeverisë dhe të vendit, natyrisht se reflektojnë dhe krijojnë një pozitivitet. Ndërsa ambiciet personale, pozicionet, përfitimet e ngushta nuk i takojnë botës time personale dhe botës së subjektit që përfaqësoj.

**"Epoka e re":** *Edhe gjatë mbledhjeve të qeverisë kemi parë që AAK-ja ka votuar disa herë kundër vendimeve të qeverisë?*

**Berisha:** Mendoj se përgjigjen më të mirë për këtë mund ta japin përfaqësuesit e AAK-së. Ne sot me ministrin Agim Veliu kemi koordinuar angazhimet tona në fushën e sigurisë së vendit. Tani për tani ky është prioritet për ne.

**"Epoka e re":** *Pas aksionit të policisë në Karaçevë janë paralajmëruar edhe aksione të tjera të këtij niveli. Mund të na thoni se në cilën pjesë të Kosovës mund të presim aksione të tilla?*

**Berisha:** Ministria e Punëve të Brendshme ka përgjegjësi kryesore për të krijuar një ambient të sigurt dhe stabil në vend. Mendoj se fusha e sigurisë ndikon edhe në zhvillimin e fushave të tjera. Në një vend ku nuk ka siguri, natyrisht se do të ngecin të gjitha çështjet e tjera. Prandaj, në këtë drejtim përgjegjësia jonë politike dhe institucionale është që dukuritë devijuese, si krimi i organizuar, ngado që është do ta luftojmë deri në fund.

**"Epoka e re":** *Cili është vlerësimi juaj për gjendjen e sigurisë në vend?*

**Berisha:** Mendoj se niveli i sigurisë në vend është aty ku duhet të jetë për arsye se një pjesë të kompetencave të sigurisë i kanë mekanizmat ndërkombëtarë si KFOR-i. Por, në përputhje me mandatin ligjor që ka Ministria e Punëve të Brendshme, gjendja e sigurisë është në nivelin e duhur. Kur marrim statistika nga vendet e tjera të rajonit, llogarisim se në aspektin e sigurisë Kosova është në nivelin e duhur.

**"Epoka e re":** *Mirëpo vazhdimisht kemi kritika të dy partive opozitare për mungesën e legjitimitetit të kësaj qeverie dhe për mospunën e saj?*

**Berisha:** Opozita është opozitë dhe ka për detyrë ta kritikojë qeverinë. Nuk do ta komentoja qëndrimin e opozitës. Megjithatë, mendoj se edhe opozitën duhet ta ndajmë në dy pjesë. Kemi një opozitë deri-diku konstruktive dhe një pjesë të opozitës e cila është e lindur për destruktivitet.

**"Epoka e re":** *Është folur shumë për mundësinë e zgjerimit të koalicionit qeverisës. Cili është mendimi juaj për këtë çështje?*

**Berisha:** Besoj se në situatën politike në të cilën gjendet Kosova, kërkohet një qeveri më stabile, pra edhe në kuptimin e numrave, ideve dhe vizioneve që kanë subjektet politike. Rrethanat në të cilat gjendet Kosova, zhvillimet politike dhe të sigurisë rreth Kosovës e bëjnë të nevojshëm krijimin e një stabiliteti më të madh qeverisës. Kjo duhet të ndodhë jo pse kjo qeveri nuk ka stabilitet, por për shkaqe të tjera. Tani jemi në momente përfundimtare të zgjidhjes së problemit me Serbinë, i cili e ka përcjellë çdo qeveri pas zgjedhjeve në këto 20 vjet. Prandaj, duke i parë këto zhvillime, qeveria aktuale duhet të forcohet në mënyrë që disa problemeve një herë e përgjithmonë t'u japë fund.

**"Epoka e re":** *PDK-ja ka hedhur poshtë çdo mundësi se mund t'i bashkohet qeverisë. A pritet që në të ardhmen të jetë pjesë e këtij koalicioni?*

**Berisha:** Nuk dua të komentoj këtë, por po them se forcimi i kësaj qeverie do t'i shërbente interesit të Kosovës.

# Veliu emëroi zëvendësministrat e MPB-së në cilësinë e koordinatorëve nacionalë



Prishtinë, 21 shtator (ER) - Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agim Veliu, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive që ka, të hënën ka emëruar në cilësinë e koordinatorëve nacional zëvendësministrat e MPB-së për strategjitë e përcaktuar. Për detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Nacional kundër krimit të organizuar, Koordinatorit Nacional për parandalimin e krimit dhe Koordinatorit Nacional për kontrollin e armëve të vogla, të lehta dhe eksplozivëve është autorizuar zëvendësministri i MPB-së, Agron Bacaj.

Po ashtu, ministri Veliu emëroi zëvendësministrin Zafir Berisha t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Nacional për siguri kibernetike dhe të Koordinatorit Nacional për menaxhimin e emergjencave.

Ndërsa zëvendësministri Milan Radojeviq është emëruar Koordinator Nacional kundër narkotikëve, Koordinator Nacional për siguri në bashkësi dhe Koordinator Nacional kundër trafikimit të njerëzve.

Zëvendësministri Yildiray Bajram është autorizuar nga ministri Veliu t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Nacional për menaxhim të integruar të kufirit dhe Koordinatorit Nacional për riintegrim dhe riatdhesim të personave si dhe të Koordinatorit Nacional për migrim.

# HUNGARIA VLERËSON SE KOSOVA I KA PËRMBUSHUR TË GJITHA OBLIGIMET PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 21 shtator** - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të hënën në takim njoftues ambasadorin e ri të Hungarisë në Kosovë, Jozsef Bencze, me të cilin ka biseduar për marrëdhëniet dypalëshe dhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit të ndërsjellë, veçmas në ekonomi dhe në arsim. Duke i dëshiruar mirëseardhje ambasadorit Bencze, kryeministri Hoti shprehu mirënjohjen e qeverisë dhe të qytetarëve të Kosovës për mbështetjen e përhershme që Hungaria i ka dhënë dhe po i jep vendit tonë.

Kryeministri Hoti e njoftoi ambasadorin Bencze për prioritetet e Qeverisë së Kosovës, për parandalimin dhe menaxhimin e pandemisë Covid-19, për pakon e rimëkëmbjes ekonomike dhe për forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit. Po ashtu, kryeministri Hoti ka foluri edhe për dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë që duhet të përfundojë me njohje reciproke.

Ndërsa ambasadori Bencze riafirmoi mbështetjen e Hungarisë për Kosovën, duke ofruar kredi prej 62 milionë eurosh, e cila pritet të ratifikohet nga Kuvendi i Kosovës. Po në këtë takim u diskutua edhe për organizimin e takimit të Këshillit Ekonomik Kosovë - Hungari, si dhe për shkëmbimin e vizitave reciproke në nivel të lartë dhe nënshkrimin e Protokollit për bashkëpunim në fushë të arsimit.

Kur është fjala për arsimin, duhet theksuar se Hungaria ka ndarë 75 bursa universitare për studentët nga Kosova. "Hungaria konsideron se Kosova i ka përmbushur të gjitha obligimet për liberalizimin e vizave", theksoi ambasadori Jozsef Bencze, i cili e siguroi kryeministrin Hoti se Hungaria do të vazhdojë ta mbështesë edhe më tej agjendën e integrimit europerëndimor të Republikës së Kosovës.





# PËRUROHET SHTATORJA E KOLONEL AHMET KRASNIQIT

**Vushtrri, 21 shtator (ER)** - Të hënën në Vushtrri është bërë zbulimi i shtatores së kolonel Ahmet Krasniqit. Aty morën pjesë kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, kryeministri Avdullah Hoti, kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ministra dhe deputetë. Në këtë ceremoni kryetarja e Kuvendit e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se Tirana zyrtare ia ka borxh Kosovës zbardhjen e vrasjes së Ahmet Krasniqit. Ajo u shpreh se kolonel Krasniqi u vra nga dikush që e pati për detyrë që ushtarët t'i lë pa komandant dhe se kjo ishte goditje ndaj idesë së unifikimit që, sipas Osmanit, mungon edhe aktualisht në Kosovë.

Osmani ka thënë se Kosova e ka të ardhmen e zorshme derisa nuk zbardhen vrasjet politike. "Jam vërtet e nderuar që sot, këtu në Vushtrrinë e Hasan Prishtinës, mund t'ju drejtohem me një fjalë rasti, në këtë ceremoni të veçantë e shumë të rëndësishme jo vetëm për qytetin tuaj, por për të gjithë Kosovën, në ceremoninë e përurimit të shtatores së heroit të Kosovës, kolonel Ahmet Krasniqi. Përtej simbolikës së zakonshme të nderimit të një njeriu kaq madhështor si Ahmet Krasniqi, ky akt nënkupton rikthimin e tij ngadhënjyes në vendlindje, rikthimin te njerëzit e vet, që e duan dhe e njohin si komandant të parë të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës, si nismëtar institucional i luftës për liri dhe pavarësi, si hero i Republikës së Kosovës", ka thënë kryeministri Avdullah Hoti në fjalën e tij.

Ai ka thënë se dita e sotme për të gjithë ata që ia duan të mirën Kosovës shënon rilindjen shpirtërore të kolonel Ahmet Krasniqit. "Shënon kthimin e tij përfundimtar ndër ne, ashtu siç ishte ai në jetë, i urtë dhe hijerëndë, vizionar dhe profesionist i shkëlqyeshëm ushtarak, njeri i fjalës dhe i sakrificës", është shprehur kryeministri Hoti.

E ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka thënë se plumbat që goditën Krasniqin ishin plumba kundër lirisë së Kosovës. "Kolonelin filluan ta rrethojnë injorantët, mashtruesit, sabotuesit, profiterët e dezinformuesit, që të gjithë vegla e instrumente në shërbim të aparaturës shtetërore të Serbisë. Plumbat e shkrepur në natën e 21 shtatorit mbi trupin e kolonelit ishin plumba kundër lirisë", ka deklaruar Quni.

## Ndahen mbi dy milionë euro për regjistrimin e popullsisë



**Prishtinë, 21 shtator** - Qeveria e Kosovës ka miratuar dokumentin për regjistrimin e popullsisë për vitin 2021. Zëvendësministri i Financave, Agim Krasniqi, ka thënë se ky dokument krijon kosto shtesë buxhetore me mbi dy milionë. Ai ka thënë se ky dokument është në pajtim me politikat qeveritare, ku përcaktohen objektiva me regjistrimin e popullsisë. "Agjencia e Statistikave ka paraqitur tri opsione. Sekretariati koordinues vlerëson se draftdokumenti është në përputhje me strukturat e parapara, ku krijon kosto shtesë buxhetore mbi 2 milionë për vitin 2021/2023. Kjo kosto është e kërkuar për stafin që do të punojë", ka thënë Krasniqi.

Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka njoftuar se nga 15 shtatori ka filluar punën në terren për pilotregjistrimin e popullsisë, ndërsa ky pilotprojekt do të zgjasë deri më 14 tetor 2020.

# Qeveria mbështet me 70 mijë euro arsimin në Luginën e Preshevës

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e rregullt të saj ka ndarë 70 mijë euro në emër të ndihmës për blerjen e librave dhe materialeve shkollore për nevojat e nxënësve të Komunës së Bujanovcit, të Komunës së Medvegjës dhe Komunës së Preshevës. Po në këtë mbledhje të qeverisë është miratuar edhe vendimi për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, ka zhvilluar të hënën mbledhjen e rregullt, në të cilën ka miratuar projektligje, rregullore, vendime, koncept-dokumente dhe dokumente të tjera nga fushat e përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore të qeverisë.

Në hapje të mbledhjes, me kërkesë të kryeministrit, ministri i Punëve të Brendshme e ka njoftuar kabinetin qeveritar për aksionin e Policisë së Kosovës kundër krimit dhe veprimtarisë ilegale në Karaçevë dhe në disa vende të tjera të Kosovës.

Ministri Agim Veliu ka theksuar se aksioni ka qenë i planifikuar dhe përgatitur pas grumbullimit të dëshmive dhe provave për zhvillimin e aktiviteteve të jashtëligjshme në këto vende.

Në këtë aksion janë arrestuar 37 persona, janë konfiskuar shumë prova materiale të veprimtarisë ilegale dhe janë rrënuar 12 objekte. Në mesin e të arrestuarve janë edhe 12 zyrtarë policorë.

Ministri Veliu ka shprehur vendosmërinë e vazhdimit të luftës kundër krimit dhe çdo veprimtarie joligjore në Republikën e Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë 70 mijë euro në emër të ndihmës për blerjen e librave dhe materialeve shkollore për nevojat e nxënësve të Komunës së Bujanovcit, të Komunës së Medvegjës dhe Komunës së Preshevës.

Po në këtë mbledhje të qeverisë është miratuar edhe vendimi për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë.

Me plotësim-ndryshimet e ligjit rregullohet statusi juridik i bashkësive fetare në Republikën e Kosovës. Ligji njeh pesë bashkësi fetare në Republikën e Kosovës: Bashkësia Islame e Kosovës; Kisha Ortodokse Serbe; Kisha Katolike; Bashkësia e Besimit Hebre; Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës; dhe Bashkësia e Tarikateve të Kosovës.

Në këtë mbledhje janë miratuar edhe dy rregullore: Rregullorja për procedurën e vlerësimit të realizimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë dhe nëpunësve të shërbimeve publike. Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret, metodologjinë dhe procedurat për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë dhe nëpunësve të shërbimeve publike, dhe rregullorja për integrimin e personave të riatdhesuar, e cila përcakton organet vendimmarrëse dhe koordinuese për menaxhimin e procesit të riintegrimit si dhe procedurat dhe kriteret e përfitimit nga skemat e riintegrimit.

Qeveria ka miratuar vendimin për aprovimin e nismës për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare për financimin dhe drejtimin e zbatimit të projektit Heras+/Arsimi i lartë, Hulumtimi dhe Shkenca Aplikative në Kosovë mes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Ka marrë miratimin e kabinetit qeveritar edhe nisma për lidhjen e Protokollit për ndryshim dhe shtesë në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për Bashkëpunimin të Ndërsjellë në Fushën e Sigurisë.

Shpend Tërdevaj është emëruar sekretar i përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Mandati i Sekretarit të Përgjithshëm zgjat katër vjet.

## Skender Hyseni do ta ketë pagën sa të një zëvendësministri

Në mbledhjen e qeverisë është miratuar edhe vendimi për Zyrën e Koordinatorit Shtetëror për Dialog me Serbinë, i cili përcakton pagën e Koordinatorit Shtetëror për Dialog me Serbinë, të barasvlershme me pagën e zëvendësministrit. Vendimi rregullon edhe kompensimin për ndihmësit (asistentët) profesionalë të përkohshëm të Koordinatorit Shtetëror për Dialog me Serbinë, kompensohen ngjashëm me pozitën e asistentit/es së kryeministrit. Koordinatori mund të angazhojë ekspertë të përkohshëm për tema specifike, të cilët paguhen sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe kompensimin dhe shpenzimet e udhëtimit duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 07/2004 dhe Vendimin e Ministrit të Financave Nr. 30/2018, të datës 19 qershor 2018, për tarifat e rishikuara për udhëtime jashtë vendit.

# Veliu takon menaxherët e burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike

PRISHTINË, 21 SHTATOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka mbajtur të hënën takim me menaxherët e burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike, ku është diskutuar për përgatitjet që ka bërë MPB-ja për fillimin e zbatimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe për realizimin e procedurave teknike përmes Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore-SIMBNJ.

Nga 29 aktet nënligjore që kërkohet të përgatiten për zbatim të Ligjit për Zyrtarët Publikë, MPB-ja deri më tani ka përgatitur tri akte nënligjore që janë nënshkruar nga ministri i MPB-së dhe shtatë të tjera të miratuara nga qeveria.

Ligji për Zyrtarët Publikë, përpos fushëveprimit, mënyrës së zhvillimit të procedurave konkurruese dhe përzgjedhëse, obligon që të gjitha procedurat e menaxhimit të zhvillohen përmes sistemit elektronik.

MPB-ja për këtë qëllim ka përshtatur sistemin, sipas kërkesave të reja ligjore.

Andaj, krahas këtyre zhvillimeve ligjore dhe teknike, ministri Veliu i njoftoi të pranishmit se procedurat e brendshme si lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë mund të fillojnë të realizohen ashtu siç parasheh ligji.

Duke ditur se proceset për menaxhimin e burimeve njerëzore, sidomos ato të pranimit në shërbimin civil, ndryshojnë dukshëm nga ato që ishin deri më tani, MPB-ja, posaçërisht departamenti përkatës, është duke punuar që deri në përmbylljen e këtyre procedurave të brendshme rekrutuese të përgatitet edhe për zhvillimin e procedurave të jashtme.



# Veseli takon odat ekonomike: Qeveria urgjentisht t'u dalë në ndihmë ndërmarrësve

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e konsideron shqetësuese sjelljen e qeverisë aktuale karshi krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia dhe neglizhencën e saj për ta kaluar Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike javën që shkoi. Kanë kaluar gjashtë muaj nga prilli kur PDK-ja ka propozuar pakon ekonomike që i përmbushte nevojat e qytetarëve dhe bizneseve, por ishte bllokuar atëkohë nga Lëvizja Vetëvendosje që udhëhiqte qeverinë.

Zyrtarët e PDK-së thonë se avazin e vjetër të bllokadës dhe paaftësisë po e vazhdon edhe kjo qeveri e udhëhequr nga LDK-ja, e cila ka propozuar në Kuvendin e Kosovës një pseudo-pako ekonomike që jo vetëm nuk i përmbush nevojat elementare të ekonomisë tonë, por fillimisht ka mashtruar qytetarët për tërheqjen e 10 përqindëshit të Trustit, duke premtuar rimbursim, ndërsa më vonë as që e përmendi.

Sipas zyrtarëve të PDK-së, nga të dhënat zyrtare të mjeteve që qytetarët kanë në Fondin e Trustit Pensional rezulton se një përqindje e madhe do të mund t'i tërheqin vetëm një shumë të vogël të mjeteve. Ky është mashtrim ndaj qytetarëve dhe nevojave të tyre të përditshme.

"Sjellja e kësaj qeverisje është e mentalitetit bllokues dhe në mungesë të numrave të saj në Kuvendin e Kosovës për ta kaluar pakon, e ka hedhur fajin tek opozita. Partia Demokratike e Kosovës, karshi përgjegjësisë së saj ndaj qytetarëve dhe bizneseve të vendit, e fton qeverinë e Kosovës që ta plotësojë Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike Covid-19, t'i marrë parasysh kërkesat e odave ekonomike dhe propozimet e PDK-së, në mënyrë që kjo të votohet brenda një dite në Kuvendin e Kosovës", thuhet në komunikatën e PDK-së.

Në këtë drejtim kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka takuar të hënën drejtuesin e Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqin, dhe të Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zekën, me të cilët ka diskutuar për krizën e thellë ekonomike të shkaktuar nga pandemia dhe ka mbështetur iniciativën e odave për përfshirjen e kërkesave të tyre në projektligj. "Si parti e qendrës së djathtë, PDK-ja vlerëson se në këtë gjendje pandemie institucionet e shtetit mund të ofrojnë lehtësira fiskale dhe t'i eliminojë procedurat burokratike, të përkrahë drejtpërdrejt ndërmarrësit e Kosovës si dhe t'i shohë praktikat më të mira evropiane të tërheqjes së mjeteve të tyre nga qytetarët prej Trustit Pensional dhe mbështes të gjitha kategoritë sociale pa dallim. Që nga fillimi i pandemisë, PDK-ja është e para dhe e vetmja parti politike që ka propozuar zyrtarisht në Kuvendin e Kosovës pakon emergjente dhe ka bërë propozime konkrete për t'i tejkaluar pasojat e rënda ekonomike", ka thënë Veseli.



# Bankat globale raportuan 2 trilionë dollarë transaksione të dyshimta

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Bankat globale për gati dy dekada kanë transferuar mbi dy trilionë dollarë pagesa, që ato besonin se ishin të dyshimta, thuhet në një raport të publikuar nga Konsorciumi Ndërkombëtar i Gazetarëve Hulumtues.

Raporti bazohet në mijëra dokumente që kanë rrjedhur në publik nga krahu i Departamentit Amerikan të Thesarit që heton pastrimin e parave.

Dokumentet tregojnë se si bankat kryesore perëndimore, përfshirë JPMorgan dhe Deutsche Bank, i kanë ndihmuar rrjetet kriminale në të gjithë botën, përfshirë ato në ish-Bashkimin Sovjetik, të lëviznin dhe të fshihnin para.

Mbi 2 100 dokumentet e Rrjetit të Krimeve Financiare janë publikuar fillimisht nga Buzzfeed dhe më pas janë shpërndarë te mbi 400 gazetarë në gjithë botën për hulumtime të mëtejshme.

Dokumentet e Rrjetit të Krimeve Financiare përbëhen nga Raporte të Aktivitetit të Dyshuar të cilat datojnë nga viti 1999 deri më 2017.




Bankat i paraqesin raportet e tilla te Rrjeti i Krimeve Financiare kur kanë shqetësime për ligjshmërinë e një transaksioni.

Bankat në të gjithë botën kanë paraqitur mbi dy milionë raporte të aktivitetit të dyshuar vitin e kaluar.

Më 2017 dokumente sekrete globale kanë rrjedhur edhe nga Appleby dhe Estera, dy ofrues të shërbimeve ligjore. Të njohura si Letrat e Parajsës, ato kanë zbuluar marrëdhëniet financiare të politikanëve, celebritëve dhe udhëheqësve të biznesit.

# Kosova dhe Japonia do të mbajnë konferencë të përbashkët ekonomike



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 21 shtator - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të hënën në takim ambasadorin jorezident të Japonisë në Kosovë, Akira Mizutani, me të cilin ka biseduar për zhvillimet e përgjithshme në vend dhe për raportet bilaterale ndërmjet dy vendeve.

Ambasadori Akira Mizutani e përgëzoi kryeministrin Hoti për lidershipin e tij, për arritjen e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike me Serbinë që mund të shpjerë në rritje të stabilitetit në Ballkanin Perëndimor. Po ashtu, ai theksoi mbështetjen e Japonisë për proceset aktuale në Kosovë, me theks të veçantë për mbështetjen për menaxhimin dhe parandalimin e pandemisë siç është furnizimi me maska mbrojtëse nëpërmjet UNICEF-it me vlerë 640.000 euro, si dhe sigurimi i terapisë antivirale nga Japonia për 100 pacientë, me vlerë prej 810 000 eurosh.

"Japonia është e përkushtuar ta mbështesë Qeverinë e Kosovës për rimëkëmbjen ekonomike", theksoi ambasadori Mizutani. Në këtë kontekst, u arrit marrëveshja që të organizohet një konferencë ekonomike virtuale në mes të Japonisë dhe Kosovës, e cila do të mbahet së shpejti.

Kryeministri Hoti e njoftoi ambasadorin Mizutani për prioritetet e Qeverisë së Kosovës, për përkushtimin për rimëkëmbjen ekonomike si pasojë e pandemisë Covid-19, për procesin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë e cila duhet të rezultojë me njohje të ndërsjellë, si dhe për orientimin euroatlantik të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, kryeministri Hoti e falënderoi shtetin e Japonisë për përkrahjen e vazhdueshme që ky vend mik i ka dhënë dhe vazhdon t'i japë Kosovës, duke thënë se është në interes të dy vendeve dhe popujve tanë vazhdimi i thellimit të këtij bashkëpunimi në fusha të interesit reciprok.

# Kosova dhe Shqipëria themelojnë qendër të përbashkët të trajnimeve




Prishtinë, 21 shtator (ER) - Në Administratën Tatimore të Kosovës janë zyrtarizuar dy dokumente që i paraprin themelimit të Qendrës së Përbashkët të Trajnimeve, Kosovë - Shqipëri.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës, "Mbi Krijimin e Qendrës së Përbashkët Trajnuese", të dyja palët, ajo e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë, kanë pasur takime për hartimin e dokumenteve dhe finalizimin e tyre.

Qëllimi i themelimit të kësaj qendre trajnuese është koordinimi i veprimtarisë së përbashkët trajnuese në mes të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, nën drejtim të trajnimit të organeve fiskale të dy vendeve, në funksion të ngritjes së kapacitetit të tyre profesional dhe përshtatjes me kërkesat dhe standardet e Bashkimit Evropian, rritjen dhe zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet ministrive të financave të të dyja vendeve si dhe përfitimin e ndërsjellët si rezultat i shkëmbimit të përvojave të dy administratave në këmbimin e trajnerëve, programeve të trajnimit dhe pjesëmarrësve në trajnim.

Të dyja palët do të zhvillojnë takime të radhës me qëllim të finalizimit të planit strategjik dhe operacional për veprimtarinë e përbashkët trajnuese.

## 105 deputetë të viteve '90 do të përfitojnë nga 2 733 euro

Prishtinë, 21 shtator (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në mbledhjen e qeverisë mbajtur të hënën, ka paraqitur propozimin për miratimin e vendimit për kompensimin financiar për delegatët e legjislaturës së vitit 1990. Në arsyetimin e tij ministri Reçica tha se janë këta delegatë të cilët kanë marrë pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës më 2 korrik dhe 7 shtator dhe kanë vazhduar mbajtjen e mbledhjeve deri më 24 maj 1992. Nga ky vendim 105 deputetë do të përfitojnë proporcionalisht shumën prej 2 733 eurosh. Për ata deputetë që nuk janë në jetë, kompensimin e plotë financiar të njëhershëm do ta gëzojnë bashkëshortja/e veja e deputetit, apo fëmija deri në moshën 18-vjeçare, ndërsa nëse janë në studime, deri në moshën 26-vjeçare.

Me këtë vendim, Qeveria e Kosovës përmbushi edhe një obligim ndaj atyre që në kohë të vështira patën guximin intelektual e kombëtar që të jenë krah me popullin, duke shpallur Kosovën Republikë dhe duke nxjerr Kushtetutën e



Kaçanikut, akte këto të cilat iu paraprinë zhvillimeve të mëdha në vitet e mëpasme në vendin tonë.

# Lakorja e infeksionit me Covid-19 në Gjilan po bie



GJILAN, 21 SHTATOR (ER) - Nën udhëheqjen e nënkryetarit të Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, është mbajtur të hënën takimi i Komitetit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19, ku është bërë vlerësimi i përgjithshëm.
Në takim nënkryetari Ismajli ka thënë se ndihet mirë që lakorja e infeksionit me Covid-19 në Gjilan po bie falë përkushtimit institucional dhe lojalitetit qytetar.
Në këtë takim ka dalë apeli i përbashkët për qytetarët që të vazhdojnë t'u përmbahen rekomandimeve të institucioneve, përfshirë bartjen e maskave, mbajtjen e distancës dhe higjienën personale.
Pasqyra e përgjithshme e përballjes së Komunës së Gjilanit me pandeminë është kjo: 982 të infektuar në total, 860 të shëruar, 71 raste aktive, 18 të hospitalizuar dhe 44 të vdekur.

# 'Dita pa makina në Prizren'



PRIZREN, 21 SHTATOR (ER) - Të martën, më 22 shtator, në Prizren do të organizohet aktiviteti "Dita pa makina", që është një ngjarje e lirë ndërkombëtare e cila organizohet me qëllim të shfrytëzimit të sa më pak makinave, si një prej ndotësve kryesorë të ajrit dhe nxitjes për përdorim të transportit urban dhe biçikletave.
Me rastin e organizimit të këtij aktiviteti sot (e martë) një pjesë e aksit rrugor "Remzi Ademaj" dhe "Adem Jashari" do të jetë e bllokuar për automjete për një orë (11:00-12:00) dhe pikërisht në këtë segment rrugor do të ketë aktivitete të ndryshme. Gjatë kësaj kohe makinat duhet të shfrytëzojnë rrugë të tjera alternative (rr. "Faik Emrush" dhe "Fehmi Lladrovci"). "Dita pa makina" organizohet për çdo vit në rreth 2 000 qytete dhe 40 vende të ndryshme të botës.

# Kamberi dhe përfaqësuesi i KFOR-it amerikan bisedojnë për sigurinë në Mitrovicë



MITROVICË, 21 SHTATOR (ER) - Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, Safet Kamberi, ka pritur në takim pune përfaqësuesin e KFOR-it amerikan, kolonel Noel Hoback. Në këtë takim është biseduar lidhur me aspektet e sigurisë në vend, me theks të veçantë për veriun e Kosovës, si dhe menaxhimin e pandemisë nga institucionet lokale. Me këtë rast u potencua se situata aktuale në veri të vendit është stabile dhe se prania e KFOR-it, veçanërisht atij amerikan, duhet të jetë e pranishme çdoherë për ofrimin e sigurisë së qytetarëve tanë. Gjithashtu, gjatë këtij takimi kryesuesi Kamberi ka falënderuar për bashkëpunimin e mirë dhe për kontributin e KFOR-it amerikan, të cilët në vazhdimësi e kanë përkrahur Komunën e Mitrovicës.

# Inspektorati i Malishevës detyron marketet t'i ndajnë produktet me vaj të palmës




MALISHEVË, 21 SHTATOR (ER) - Inspektorati i Komunës së Malishevës është duke mbikëqyrur zbatimin e vendimit të Ministrisë për Tregti dhe Industri për ndarjen e produkteve të vajit të palmës dhe me këtë rast është duke i detyruar marketet dhe dyqanet që t'i ndajnë fizikisht produktet që përmbajnë vaj palme në kënde të veçanta nga prodhimet e tjera. Kështu ka deklaruar drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit në Malishevës, Dibran Kastrati, i cili ka thënë se këtë masë janë duke e ndërmarrë pasi MTI e ka ndaluar përkohësisht përdorimin e këtij produkti. Sipas tij, "inspektorët komunalë, gjatë inspektimit të vazhdueshëm që e bëjnë në dyqane dhe markete, do ta zbatojnë masën e vendosur nga ana e ministrisë".

# Komuna e Obiliqit subvencionon nënat vetushqyese dhe gratë në biznes me 50 mijë euro



OBILIQ, 21 SHTATOR (ER) - Komuna e Obiliqit ka ndihmuar me të holla 38 gra vetushqyese dhe gra të përfshira në biznes. Kryetari i kësaj komune, Xhafer Gashi, ka nënshkruar marrëveshjen për implementimin e projekteve dhe ndarjen e mjeteve financiare me përfitueset e grant-skemës. "Nga kjo grant-skemë, përfituese janë 38 gra me biznese nga sfera të ndryshme: floktari, bletari, rrobaqepësi si dhe biznese të vogla dhe fillestare, duke përfshirë të gjitha komunitetet e Komunës së Obiliqit, ndërsa shuma e financimit është e ndarë në dy loto: Loti 1 (startUp biznese të reja) nga 1 000.00 euro deri në 1 500.00 euro dhe Loti 2 (bizneset ekzistuese mikro dhe të vogla me qarkullim deri në 2 000.00 euro) nga 1 000.00 euro deri 2 500.00 euro", thuhet në njoftimin e komunës së Vushtrrisë.
Gashi ka uruar përfitueset e grant-skeme dhe është shprehur mjaft i lumtur që po implementohet në këtë komunë. Vlera e këtij granti është 50 000.00 euro në kuadër të subvencioneve të Komunës së Obiliqit.

# DOSJET E SPECIALES?



Shkruan: Hysni GUCATI

Organizata e OVL UÇK-së qysh herët ka qenë në dijeni të plotë për bashkëpunimin e prokurorisë serbe, policisë hetuese, gjykatave serbe në Serbi me Gjykatën Speciale në Hagë. Kemi qenë në dijeni për kërcënimin e dëshmitarëve nga ana e Serbisë për të dëshmuar kundër strukturave të UÇK-së dhe për këtë Gjykata Speciale ka heshtur. Shpesh jemi prononcuar publikisht se Gjykata Speciale është e njëanshme dhe e formuar ekskluzivisht vetëm për strukturat e UÇK-së. Askund në botë nëse kemi një luftë dypalëshe nuk mund të ndiqet vetëm njëra palë. Ky precedan i paparë ndonjëherë në praktikat gjyqësore ndodhi kundër UÇK-së. Bota gjerë më tani nuk njeh gjykatë më të padrejtë, më raciste e degraduese pos gjyqeve që kanë ndodhur në kohën e inkuzicionit. Së paku në kuadër të kësaj gjykate ka qenë dashtë të dënohen krimet e Serbisë, që janë dokumentuar nga pala e Kosovës dhe drejtësia ndërkombëtare gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ne nuk pretendojmë ta zhbëjmë Gjykatën Speciale me skandalin e dosjeve që ndodhi, por publikimi i këtyre dosjeve e ka treguar seriozitetin e kësaj gjykate. Gjykata Speciale u themelua në vitin 2015 me këmbënguljen e bashkësisë ndërkombëtare, ku Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet kushtetuese për këtë gjykatë. Arsyeja se pse kjo gjykatë duhej të vendosej në Hagë ishte pikërisht për faktin se nëse do të ishte e vendosur në Kosovë, sipas zyrtarëve ndërkombëtarë, "mund të kishte frikësim të dëshmitarëve". Dosjet që kanë ardhur në zyrat e OVL të UÇK-së janë dokumente zyrtare të Gjykatës Speciale në të cilat figurojnë shumica e emrave të dëshmitarëve. Këto dosje konfidenciale kanë dalë nga zyrat e Gjykatës Speciale, prandaj këtu shihet edhe serioziteti dhe niveli i kësaj gjykate që në parim ishte dashtë të ndiqet penalisht për veprimet që i ka bërë, por edhe për rrezikimin e dëshmitarëve që gjenden në këto dokumente.

Ndihem i obliguar t'i sqaroj disa prononcime të Bekim Blakajt, drejtues i Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë e që kohë pas kohe ua mban zhagun strukturave të sigurisë serbe ku, sipas tij, "mënyra se si u prezantuan këto dokumente nga zyrtarët e OVL të UÇK-së, u la të kuptohet se qëllimi kryesor është të frikësohen dëshmitarët". Kjo është akuzë e pabazë dhe shabllonike që i bëhet Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Ky dokumentacion nuk është i UÇK-së, është i Gjykatës Speciale i cili është nxjerrë nga vetë kjo gjykatë për qëllime të tyre që ne ende nuk i dimë. Organizata e OVL UÇK-së është zgjedhur prej tyre apo lidhjeve të tyre për t'i lënë këto dosje. E kemi thënë publikisht edhe më herët, disa vite para se të ndodhë skandali me dosje se, një pjesë e dëshmitarëve që janë përpunuar në Serbi, kanë qenë të zënë robër gjatë luftës dhe të burgosur, prandaj dëshmitë e tyre janë marrë nën tortura dhe duke i shantazhuar. Disa dëshmitarë të tjerë janë nga radhët e azilkërkuesve që kanë thënë diçka sa për ta marrë statusin e azilantit, pra kanë rrejt në dëshmitë e tyre kundër UCK-së. Kurse një pjesë tjetër e dëshmitarëve janë pjesë e instrumentalizuar e partive politike të cilët i kanë cytur të bëhen dëshmitarë për shkak të rivalitetit politik. Arsyeja se pse nuk e kemi pranuar ne si organizatë OVL-UÇK, Gjykatën Speciale, është e ditur dhe plotësisht e arsyeshme. Të gjitha dyshimet dhe akuzat ndaj pjesëtarëve të UÇK-së janë ngritur në Serbi, të gjithë dëshmitarët janë përpunuar në Serbi, dëshmitë dhe akuzat kundër UÇK-së, Gjykata Speciale i ka marrë në Serbi, prandaj ne jemi duke u gjykuar nga Serbia e jo nga Gjykata Speciale pse kemi bërë ndonjë shkelje të rregullave të luftës. Jemi duke u dënuar me akuza të përpiluara në Serbi, nga një agresor që e ka shkatërruar popullin shqiptar gjatë kohës sa kemi qenë nën okupimin e tij. Nuk janë dosjet që na i sollën në zyrat e OVL-UÇK-së, që kanë treguar ndonjë risi, këto gjëra shumica janë shkruar edhe nëpër portale e mediume. Një gjë duhet ditur opinioni, se dosjet që kanë ardhur në selinë tonë janë dosje të dëmshme për UÇK-në. Unë dhe bashkëpunëtorët e mi që punojmë në OVL-UÇK jemi habitur me disa deklarata të analistëve, por edhe të disa gazetarëve të cilët kanë thënë se këto dosje janë sjellë në zyrat e OVL-UÇK me dijen e dikujt prej nesh. Edhe ju, por edhe gjithsecili prej jush e di se askush nuk e dëmton vetveten as nuk del kundër vetvetes. Dosjet që janë sjellë te ne janë korrespondenca të Serbisë me Gjykatën Speciale. Kjo gjë është e dukshme, nuk ka nevojë të ketë ekspert e njohës të fushës. Edhe për rrjedhjen e këtyre dokumenteve dhe korrespondencave mes Serbisë dhe Gjykatës Speciale në dëm të UCK-së, duhet pyetur Gjykatën Speciale për Krime Lufte të Serbisë dhe Gjykatën Speciale më Zyra në Hagë, se cila prej këtyre i ka nxjerrë këto dokumente tepër sekrete dhe shumë të ndjeshme për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Disa muaj para se këto dokumente të vijnë te ne nga dikush i panjohur e që organet e sigurisë po të donin e kishin kapur në flagrancë pa kurrfarë problemi, Gjykata Speciale e ka akuzuar Qeverinë e Kosovës se po bën presion në Gjykatën Speciale. Po ashtu, Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte ndërhyrë në ndalimin dhe pengimin e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, që të mos merrte pjesë në kuadër të procesit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që ishte paraparë të mbahet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Thaçi ishte i ftuar dhe e kryesonte Kosovën në këto bisedime. Ky akt që e ndërmori Gjykata Speciale kundër Hashim Thaçit tregon qartë se Gjykata Speciale është pjesë e ingranimeve politike dhe se indirekt e mban anën e Serbisë. Edhe ashtu Gjykata Speciale nënkupton Gjykatën e Kosovës me Dhoma të Specializuara në Hagë, me prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë, me policë dhe hetues të huaj si dhe me përkthyes të huaj. Gjykata në fjalë edhe porositë për akuza i merr në serbi. Nuk është e pavarur. Në disa shkrime gazetarët kanë bërë pyetje publike, përse personi i panjohur i ka dërguar dosjet në OVL-UÇK e nuk i ka adresuar diku tjetër. Ky veprim ka shumë dimensione, së pari publikimi i dosjeve është punë e ndjeshme, dosjet kanë të bëjnë me dëshmitë që i kanë dhënë dëshmitarët kundër strukturave të UÇK-së dhe ata që e kanë zgjedhur OVL-UÇK për t'i lënë dosjet e kanë qitur para një përgjegjësie të madhe sigurisht për të gabuar. Sidoqoftë, organizata e OVL UÇK-së nuk është për t'i përmirësuar gabimet dhe dështimet e askujt. Ne jemi për t'i mbrojtur vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lirinë e Kosovës, pavarësinë e Kosovës që u fitua me mundin e sakrificat e qindra e mijëra qytetarëve të Kosovës dhe me gjakun e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mos harroni se këtë që është duke e bërë Gjykata Speciale, njëanshëm kundër UÇK-së, në një të ardhme të shkurtër do të gjykohet nga e gjithë bota demokratike si njëra nga padrejtësitë e shekullit që iu bë UÇK-së.

**(Autori është kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës)**

# PSE PO VJEN GRENELLI PËRSËRI NË BALLKAN?



Shkruan: Faton ABDULLAHU

1) Grenelli ditë më parë është ankuar se marrëveshjes së arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në ShBA nuk i është dhënë vend i merituar, as populllaritet i mjaftueshëm. Ardhja e Grenellit duket se, pos të tjerash, ka për qëllim që ta tërheqë vëmendjen edhe një herë në atë që Administrata Tramp e quan marrëveshje historike.

2) Marrëveshja më 4 shtator në Uashington, tash edhe kjo vizitë e Grenellit në Kosovë, po i jep shpejt dhe shumë atë që po i mungon tash sa kohë Qeverisë Hoti - seriozitet dhe efikasitet duke eklipsuar jo pak mossukseset e saj, sidomos në menaxhimin e pandemisë dhe fillimit të mësimit në shkolla.

3) Për shkak se edhe në Serbi dhe në Kosovë po thuhet shpesh se marrëveshja ishte e përgjithshme, pa konkretizime dhe obligime të detajuara, si duket Grenell vjen prapë në Prishtinë dhe Beograd, por edhe gjetiu që ta ndryshojë këtë perceptim kritik, dhe kësaj radhe edhe me institucione financiare dhe përgjegjësit e tyre - magnat financiarë.

4) Më së shumti nga ardhja e Grenellit humb LV-ja e cila, pas gati dy dekadash, tash ka prekur kulmin me refuzimin dhe paragjykimin apriori të çdo gjëje që amerikanët bëjnë në Kosovë dhe për Kosovën.

5) Më së shumti fiton qeveria aktuale, përkatësisht LDK-ja dhe kryeministri Hoti. Edhe përkundër jo pak mangësive të marrëveshjes, kjo perceptohet jo pak kështu, sidomos kur vihet në raport me qasjen e LV-së e cila nuk bën opozitarizëm kritik e analitik, por refuzim përjashtues pa qëllim pragmatik.

6) Ta dëgjosh opozitën e Serbisë se çfarë thotë për marrëveshjen në Uashington, ta merr mendja se Kosova me këtë marrëveshje është njohur përfundimisht nga Serbia, se kryeministri Hoti ka qenë i shkëlqyeshëm në dialogun dhe se Vuçiqi është tradhtar i kombit serb. Asnjëra nuk është e saktë nga këto.

7) Ta dëgjosh LV-në se çfarë thotë për marrëveshjen ta merr mendja se me këtë zotim toka dhe uji i Kosovës po ndahen me Serbinë, se kryeministri Hoti është tradhtar dhe se amerikanët tani janë me Serbinë. Edhe këto janë plotësisht të pasakta.

8. Vizita e Grenellit mund të sjellë edhe befasi sot në Ballkan. Duket se edhe Greqia do të ketë një rol të ri në krejt këtë proces. Shpresojmë se këtë involvim të Greqisë ajo do të duhet ta paguajë me njohje të Kosovës.

9) ShBA-ja dëshmon se në këtë pjesë të Evropës ka rirreshtim të ri gjeopolitik të cilës ajo po i prinë duke ia vënë themelet ekonomike e të cilat do ta determinojnë politikën në rajon e më gjerë. Këtë duhet ta pranojnë gjithë të tjerët. Ka kohë ende që të nxirren edhe të mira të tjera për Kosovën nga kjo marrëveshje, por dyshoj se këtë mund ta bëjë qeveria aktuale.

## Orban mbështet Trumpin në zgjedhjet e nëntorit



BUDAPEST, 21 SHTATOR- Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, ka mbështetur presidentin amerikan, Donald Trump, në garën e tij për rizgjedhje, duke thënë se rivalët e tij nga Partia Demokratike e kanë detyruar "imperializmin moral" në botë.

"Ne e mbështesim fitoren e Donald Trumpit, sepse e dimë mirë diplomacinë e qeverive demokratike amerikane, të ndërtuar mbi imperializmin moral. Ne kemi qenë të detyruar ta provojmë atë më parë, nuk na ka pëlqyer dhe nuk e duam një tjetër", ka shkruar Orban në një artikull të botuar në të përditshmen hungareze Magyar Nemzet.

Zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara mbahen në nëntor.

Orban, nacionalist i krahut të djathtë, përballet me zgjedhjet parlamentare në fillim të vitit 2022.

# Si duhet të reagojnë shkollat në rast të përhapjes së koronavirusit?




PRISHTINË, 21 SHTATOR - Tetë fëmijë nën moshën 10 vjeç dhe tetë mësimdhënës të Shkollës Fillore "Mustafë Venhari" në Vushtrri kanë rezultuar pozitivë me Covid-19 në javën e parë të fillimit të mësimit, bëri të ditur kryetari i kësaj komune, Xhafer Tahiri. Ai tregoi se janë në pritje të rezultateve të testeve edhe të nxënësve të dy klasave në të cilat kanë rezultuar dy të infektuar, kurse negativë në test për koronavirus kanë rezultuar dy klasa të tjera dhe personeli tjetër i shkollës.

"Mësimdhënësit kanë rezultuar pozitivë pasi kanë rezultuar nxënësit. Vetëm një nxënës ka pasur simptoma, më pas kemi filluar testimin dhe kanë rezultuar pozitivë të tjerët. Mësimdhënësi dhe nxënësit janë në shtëpi dhe nuk kanë simptoma të rënda", ka thënë Tahiri.

Viti i ri shkollor në institucionet parauniversitare në Kosovë ka filluar më 14 shtator, me prani fizike të nxënësve në shkolla, por duke respektuar rekomandimet për mbrojtjen nga pandemia e koronavirusit: mbajtjen e maskës, distancën dhe higjienën personale. Por, Ministria e Arsimit dhe Shkencës tashmë ka përgatitur tre skenarë për mbarëvajtjen e procesit mësimor që do të zbatohen nga komunat, varësisht gjendjes epidemiologjike me pandeminë e shkaktuar nga koronavirusi.

Procesi mësimor në shkollën fillore "Mustafë Venhari" tashmë ka kaluar nga skenari A, që do të thotë nga prania fizike në shkollë, në skenarin C, mësim në distancë, thotë për "Radion Evropa e Lirë", Xhafer Tahiri. "Pas dy javësh do të ulemi së bashku me Task-Forcën komunale të arsimit, Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike Kosovës (IKShP) me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Shëndetësisë, për ta rivlerësuar situatën dhe për të parë se kur mund të kthehen fëmijët në shkollë", ka theksuar Tahiri.

### MASh: Mbyllja e shkollave varet nga numri i nxënësve të infektuar

Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Xhavit Rexha, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se vendimi për kalimin e mësimit nga shkolla në distancë varet nga numri i përgjithshëm i nxënësve i të infektuarve. "Niveli është 200 me 1. Nëse në një shkollë ka 1000 nxënës dhe infektohen me koronavirus më shumë se pesë nxënës, mësimi kalon në mënyrën nga distanca. Kalimi në online është bërë në përputhje me protokollin e reagimit. Protokolli përcakton mënyrat në të cilat mësimi kalon në formën online", ka thënë Rexha.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës tashmë ka hartuar Protokollin e reagimit ndaj pandemisë Covid-19 në shkolla, ku përcaktohen mënyrat e reagimit dhe menaxhimit të personelit të shkollave dhe Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA), në rast të paraqitjes së rasteve të infektimit individual apo grupor ose personalit të shkollave. Në këtë protokoll thuhet se, "pas skadimit të infeksionit në raste individuale, shkollat dhe autoritetet vendore duhet të vendosin për rikthimin eventual në skenarin (C-B ose B-A).

### SBAShK: Në shkolla të ketë vizita të shpeshta të personelit mjekësor

Zyrtarë të Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë konsiderojnë se vizitat e mjekëve duhet të jenë më të shpeshta në objektet e shkollave. Rrahman Jasharaj, kryetar i kësaj sindikate, thotë se në shkollat që kanë mbi 500 nxënës është nevojë e domosdoshme të ketë vizita të shpeshta mjekësore. "Nëse nuk ka mundësi që të ketë personel mjekësor, që të qëndrojë vazhdimisht në shkolla, së paku mjekët t'i vizitojnë shumë shpesh institucionet arsimore. Me organizim të drejtorive komunale të arsimimit, t'u bëhen vizita mjekësore nxënësve në mënyrë që të shihet nga afër situata", shprehet Jasharaj.

Në fillim të muajit shtator, para se të fillojë procesi mësimor, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka njoftuar se do të realizohet testimi për koronavirus ndaj 1 500 mësimdhënësve në nivel vendi. Testimi ende nuk ka përfunduar, kurse personeli arsimor zgjidhet rastësisht, pa pasur ndonjë simptomë të dyshimtë.

Kurse në protokollin e reagimit ndaj pandemisë Covid-19 në shkolla, përmendet "mundësia për kryerjen e shpejtë të testimeve për Covid-19, për punëtorët arsimorë sipas nevojave të shkollave-komunave". Për këtë qëllim, MASh-i dhe qeveria duhet të rezervojnë për nevoja të shkollave së paku 5 000 doza të testimeve që të jenë në dispozicion të Drejtorive Komunale të Arsimit.

## Qindra migrantë në Greqi të infektuar me koronavirusin e ri



ATHINË, 21 SHTATOR- Më shumë se 240 migrantë në një kamp të ri, të përkohshëm në ishullin grek të Lesbos, janë infektuar me koronavirusin e ri, tha të hënën Agjencia e Shëndetit Publik në Greqi.

Rezultatet dolën pas testimit të rreth 7 000 personave.

Më 8 shtator, një zjarr që shpërtheu në kampin Moria të ishullit Lesbos, detyroi 12 000 migrantë të largohen prej aty, derisa autoritetet ndërtuan me shpejtësi një kamp të ri të përkohshëm. Gjashtë të rinj afganë përballen me akuza për zjarrvënie, raporton AFP. U desh më shumë se një javë që shumica e azilkërkuesve të ri-strehohen në kampin e ri. Që nga marsi, kufizimet e lëvizjes në kampin Moria ishin edhe më të rrepta për shkak të pandemisë së virusit koronavirus.




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Zekolli: Liga Unike do t'i rritë vlerat dhe konkurrencën në basketbollin shqiptar

"Mendoj se kjo është një ide shumë e mirë dhe sfida më e madhe besoj se do të jetë pandemia Covid-19. Nëse nuk ka pengesa me pandeminë, atëherë besoj se do të funksionojë dhe nuk do të ketë problem", ka thënë Ferit Zekolli



PRISHTINË, 21 SHTATOR - Një nga basketbollistët më të dalluar të Kosovës ndër vite është Ferit Zekolli. Ai për 20 vjet karrierë ka luajtur në Kosovë, Kroaci dhe Serbi. Zekolli ka luajtur për Trepçën dhe Universitetin e Prishtinës, duke lënë gjurmë në basketbollin e Kosovës, të Ballkanit, por dhe më gjerë. Ai luajti me plot sukses në ish-Ligën e Jugosllavisë. Së fundi Federata e Basketbollit e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kanë nënshkruar formimin e Ligës Unike mes dy vendeve, ku do të marrin pjesë katër skuadrat më të mira të Kosovës dhe katër më të mirat e Shqipërisë. Zekolli ka thënë për faqen zyrtare të Federatës së Basketbollit të Kosovës se kjo është një ide shumë e mirë. "Mendoj se kjo është një ide shumë e mirë dhe sfida më e madhe besoj se do të jetë pandemia me Covid-19. Nëse nuk ka pengesa me pandeminë, atëherë besoj se do të funksionoj dhe nuk do të ketë problem", ka thënë Zekolli, ish-qendra 210 centimetra, duke u dalluar nga lojtarët tjerë.

Ish-basketbollisti i Zarës së Kroacisë tregon çka mund të fitojnë dy vendet nga kjo ligë. "Kjo ligë do t'i rritë vlerat dhe konkurrencën, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri. Të dyja vendet kanë pasur nevojë për një ligë të tillë, ku mendoj se do ta rritë interesimin për basketboll si në Kosovë, po ashtu edhe në Shqipëri. Sigurisht se klubet duhet t'u japin hapësirë lojtarëve të rinj dhe të punojnë më shumë me gjenerata të reja, sepse ata janë e ardhmja dhe meritojnë vëmendjen, por edhe përkrahjen më të madhe. Pikërisht kjo ligë është një mundësi për basketbollistët e rinj të tregojnë aftësitë e tyre dhe të fitojnë përvojë. E theksoj edhe një herë se kjo ligë është një ide e mirë dhe shpresoj se do të funksionojë siç është më së miri", ka shtuar Zekolli.

Liga Unike do të fillojë në fund të muajit tetor, ku në edicionin e parë do të luajnë katër skuadrat më të mirat nga Kosova dhe katër më të mirat nga Shqipëria. Dy skuadrat e para kualifikohen direkt në gjysmëfinale, derisa për dy vende do të luajnë 3-6 dhe 4-5.

## SHKURT

### Islami vazhdon me Feronikelin

Mbrojtësi Përparim Islami e ka vazhduar kontratën me Feronikelin. Islami ishte pjesë e klubit nga Drenasi edhe gjatë viteve të kaluara, ku në ndeshjen ndaj Ballkanit u lëndua duke këputur ligamentin kryqëzor të gjurit të këmbës së majtë. Feronikeli, përveç që ka kryer shpenzimet e operimit të Islamit, i ka ofruar atij kontratë të re, duke përfshirë edhe kohën sa është në rikuperim nga lëndimi. Kontrata e re dëshmon që klubi nuk i ka harruar asnjëherë shërbimet dhe paraqitjet dinjitoze të tij.

### Hajdari kalon te Ponte Prizreni

Një ndër basketbollistët më të mirë vendor në vitet e fundit, Arti Hajdari, edhe zyrtarisht është pjesë e KB Ponte Prizreni. "Arti ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me mundësi vazhdimi. Arti Hajdari vitin e kaluar ishte pjesë e KB Peja, ndërsa gjysmëstinorin e parë ishte pjesë e KB Feronikeli. Me Artin skuadra është kompletuar dhe në një vendim më të shpejtë nga Ministria e Shëndetësisë skuadra do t'i fillojë stërvitjet", thuhet në njoftimin e KB Ponte Prizreni. Ndërsa Arti Hajdari është shprehur i lumtur me këtë transferim: "Jam i lumtur që kam kaluar në një klub të organizuar. Do ta bëj më të mirën të mundur nga vetja që KB Ponte Prizreni t'i arrijë objektivat e synuara".

### Marigona Hajdari, 'motori' i Ringkobingut

Marigona Hajdari edhe një herë është dëshmuar si "motori" i skuadrës daneze, Ringkobing. Ringkobingu të dielën barazoi 27:27 me Bjerringbro, ndërsa Marigona ka organizuar lojën në mënyrë të shkëlqyeshme. Lojtarja jonë është shquar edhe me efikasitet, duke realizuar pesë gola. Hapësirë në ndeshje kishte edhe motra e Marigonës, Arlinda Hajdari, që këtë herë nuk u shënua në listën e realizatoreve. Ajo mori vlerësimin e drejtuesve të klubit, njëjtë si Marigona, që është shquar edhe me asistime dhe me penalltitë që siguroi.

## Sot zhvillohen dy ndeshje në Superligë



Prishtinë, 21 shtator - Superliga e Kosovës në futboll do të rikthehet këtë mesjavë me ndeshjet e xhiros së dytë. Sot (e martë) zhvillohen dy ndeshje nga ora 16:00. Në Skenderaj, Drenica e pret Besën e Pejës, kurse në Obiliq takohen Arbëria dhe Prishtina. Të mërkurën zhvillohen dy ndeshjet e tjera për këtë xhiro, kurse derbi do të jetë në mes të Ballkanit dhe Feronikelit. Në stadiumin "Zahir Pajaziti", Llapi e pret Gjilanin që në ndeshjen e parë pësoi debakël nga "Nikli". Ndërsa ndeshja në mes Dritës dhe Trepçës '89 zhvillohet me vonë për shkak se kampionët e Kosovës në raundin e tretë parakualifikues të Ligës së Evropës do të përballen me Legian.

## Muriqi infektohet me Covid-19



ROMË, 21 SHTATOR - Igli Tare ia doli t'i sigurojë shërbimet e Vedat Muriqit, duke i dhuruar trajnerit Simone Inzaghi "pykën" e kërkuar për repartin e sulmit. Tifozët e Lazios po presin me interes të madh debutimin e "gjigantit" dardan me skuadrën e tyre të zemrës, por diçka e tillë do të vonojë. 26-vjeçari nga Prizreni është infektuar nga Covid-19. Lajmin e raporton një gazetar turk. "I uroj shërim të shpejtë Muriqit, i cili është diagnostikuar me koronavirus. Kaloje sa më shpejt këtë Vedat", shkruan Siyah Coraplilar në "Twitter". Qendërsulmuesi nuk ka asnjë simptomë dhe gëzon shëndet të mirë për momentin. Muriqi fluturoi drejt Stambollit për disa çështje burokratike në lidhje me vizën pasi kreu vizitat mjekësore dhe u prezantua si lojtari më i ri i Lazios. Rikthimi i tij në Romë do të ndodhë të shtunën.

# Bonnuci: Pirlo ka ngjashmëri me Allegrin



TORINO, 21 SHTATOR - Juventusi të dielën në mbrëmje filloi mbrojtjen e titullit kampion në Serinë A, ku të besuarit e Pirlos e nisën me këmbë të mbarë kampionatin. "Bardhezinjtë" fituan me rezultatin 3-0 në shtëpi kundër Sampdorias duke siguruar kështu tri pikët e para për këtë sezon. Leonardo Bonnuci është shprehur tepër i lumtur për fitoren e arritur si dhe tregon ndryshimet mes Andrea Pirlos dhe Maurizio Sarrit. "Kemi disa ide të reja të propozuara nga trajneri dhe stafi i tij, pak a shumë një mënyrë e re për ta interpretuar lojën. Kemi shumë entuziazëm kur kemi topin në zotërim, por edhe kur lëvizim pa top. Ndryshimi i madh në mes të Pirlos dhe Sarrit është se ne tashmë kemi iniciativë për ta gjetur më shpejt golin dhe për të siguruar kështu dhe fitoren. Po sulmojmë më shumë dhe për mua kështu është më mirë", ka deklaruar italiani për "Sky Sport Italia". "Me Sarrin lëviznim më tepër si një grup në mbrojtje, ndërsa me Pirlon jemi më shumë në lojën një me një, duke na dhënë më shumë liri për të qenë agresivë dhe për ta fituar topin. Kemi katër mesfushorë shumë të mirë që luajnë në qendër, të cilët janë agresivë. Kjo është një plus më shumë për ne dhe këtë e shikoj si ndryshim nga sezoni i kaluar", ka deklaruar Bonucci.

# Lakersat triumfojnë edhe në finalen e dytë




ORLANDO, 21 SHTATOR - Lakersat hedhin një tjetër hap të rëndësishëm drejt titullit kampion në Konferencën e Perëndimit pas fitores 105-103 ndaj Denverit në finalen e dytë "play-off" (126-114 fituan në takimin e parë). Ndeshje e dominuar shumicën e kohës nga Lakersat, por që në fund rrezikuan shumë, duke lënë rivalët të afrohen. Davis realizoi 31 pikë, shënuesi më i mirë, mbështetur nga Jamesi me 26 pikë e 11 rebound. Denveri tentoi surprizën në fund, por ishte Anthony Davis ai që realizoi koshin e fitores në sekondën e fundit. Ylli i Lakersave ishte i saktë në gjuajtjen nga distanca, duke nisur festa për ekipin nga Los Anxhelosi. Për Denverin, Jokiqi realizoi 30 pikë e Murray 25, por nuk u mbështetën sa duhet nga pjesa tjetër e skuadrës. Në Lindje, Miami udhëheq 2-1 serinë e ndeshjeve finale ndaj Bostonit (Celticsi fitoi 117-106 finalen e tretë).

## SHKURT

### Lazio dhe Torino, pas Mustafit

Numri i futbollistëve shqiptarë pritet të rritet së shpejti te Lazio ose Napoli. Këto dy skuadra janë të interesuara për mbrojtësin e Arsenalit, Shkodran Mustafi. Ish-reprezentuesi i Gjermanisë ka ringjallur karrierën me kalimin e parë në Serinë A, ndërsa një kalim tjetër mund të ndodhë që në këtë afat kalimtar. Sipas "The Sun", Lazio e Napoli e kanë shënjestruar Mustafin. "Arsenali është i hapur për t'i dëgjuar ofertat për futbollistin e Gjermanisë, që ka vetëm edhe një vit kontratë me klubin nga 'Emirates'", ka shkruar "The Sun". Rreth 13 milionë funte synon të fitojë Arsenali nga shitja e Mustafit.

### Rakitiqi pensionohet nga Kombëtarja e Kroacisë

Mesfushori Ivan Rakitiq i ka dhënë fund karrierës së tij me Kombëtaren e Kroacisë në moshën 32-vjeçare. Rakitiq, i cili u largua nga Barcelona këtë verë drejt Sevillës, ka befasuar jo pak me vendimin e tij të fundit. Vendimi i 32-vjeçarit u publikua pak më herët nga faqja e Federatës së Futbollit të Kroacisë në rrjetet sociale. Rakitiqi bëri 106 paraqitje me kombëtaren e tij, duke realizuar 15 gola. Suksesi i tij më i madh ishte arritja në finalen e Kupës së Botës të vitit 2018.

### Gundogan, pozitiv në testet e Covid-19

Ikay Gundogan është lojtari i radhës që është infektuar me Covid-19. Mesfushori i kombëtares së Gjermanisë dhe Manchester Cityt, Gundogan, është infektuar me virusin Covid-19. Lojtari do të obligohet tashmë që të vetizolohet, pas rezultateve të pranuara. Gundogan do të jetë në izolim për 10 ditë, pastaj do t'u nënshtrohet përsëri testeve.

### Sainz: Nuk jam penduar që kam firmosur për Ferrarin

Sezonin tjetër te Ferrari do të vijë spanjolli Carlos Sainz, që do të zërë vendin e Sebastian Vettelit. Sainzi do të largohet nga McLaren, ku po bën një paraqitje të mirë për të nisur një aventurë të vështirë te "kokëkuqja", që nuk po kalon një moment pozitiv. Në një intervistë për "Il Mundo Deportivo", Sainz ka thënë: "Shpresoj që Ferrari të bëjë një punë të mirë dhe vitin tjetër të kemi një makinë kompetitive. Nëse jo, Ferrari mbetet gjithnjë një Ferrari. Është njësoj si Real Madridi, që edhe nëse nuk është në një sezon pozitiv sërish e ndjekin të gjithë, pasi mbetet Real Madrid". "Shkoj te Ferrari me qëllimin për të fituar, pasi garoj për një skuadër legjendare. Të pilotosh këtë makinë është ëndrra e çdo piloti, shumë prej të cilëve nuk e kanë realizuar atë. Ndaj nuk jam penduar për këtë zgjedhje dhe nuk dyshoj për zgjedhjen që kam bërë".

### Suarezi arrin marrëveshje me Atleticon

Sulmuesi Luis Suarezi është jashtë planeve të Barcelonës dhe i duhet të gjente patjetër një ekip të ri gjatë kësaj merkatoje vere. Lojtari lidhej me një transferim të mundshëm te Juventusi, por gjithçka u bllokua si pasojë e dokumentacionit. Tashmë Suarezi po vazhdon negociatat me skuadrën rivale të Barcelonës, Atletico Madrid dhe ka një akord në parim. Sipas 'Mundo Deportivo', Atletico ka marrëveshje me Suarezin dhe dëshiron t'i japë atij dy vjet kontratë dhe ta bëjë sulmuesin e vet. Suarezit i mbetet që të gjejë pajtueshmëri me Barcelonën, kurse Atletico duhet ta largojë nga skuadra Diego Costën nga ekipi për t'i liruar hapësirat në majën e sulmit.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Arsim** / Department of Education

Nr.1958 /2020
Dt: 21.09.2020

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Nenit 5 (shkronja c) të Ligjit për Arsimin në Komunat e Rep. së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 17 (shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Nenit 35 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar në Rep. e Kosovës Nr. 04/L-032, të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, të UA të MASHT 10/2018 si dhe në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore, Drejtoria Komunale e Arsimit në Skenderaj, shpall:

**Konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2020/2021**

| Nr. | Niveli | Pozita | Institucioni | Vendi | Pensionim / Zëvendësim | Nr. i orëve | Nr. i pozitave |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Shfmu | Mësimdhënës/e për Gjuhë angleze | "Hamëz Jashari" "Shaban Jashari" | Skenderaj | Zëvendësim | Normë e plotë | 1 |
| 2. | Shfmu | Mësimdhënës/e për Mësim kasor | "Vëllezërit Frashëri" | Qubrel | Zëvendësim | Normë e plotë | 2 |
| 3. | Shfmu | Edukator/e 3 – 6 vjeç | IP"Nëna Zahide" | Skenderaj | Vend i lirë | Normë e plotë | 2 |
| 4. | Shfmu | Mësimdhënës/e për Mësim klasor | "Fehmi Rama" | Likoc | Zëvendësim | Normë e plotë | 1 |
| 5. | Shfmu | Edukator/e për parashkollorë | "Fehmi Rama" | Likoc | Vend i lirë | Normë e plotë | 1 |
| 6. | Shfmu | Mësimdhënës/e për Gjuhë angleze | "Bashkim Sadiku" | Tushilë | Zëvendësim | Normë e plotë | 1 |
| 7. | Shfmu | Mësimdhënës/e për Gjeografi | "Halit Geci" "Skënder Skënderi" | Llaushë, Vajnikë | Vend i lirë | 14 orë | 1 |
| 7. | Shfmu | Mësimdhënës/e për Gjeografi | "Halit Geci" "Skënder Skënderi" | Llaushë, Vajnikë | Vend i lirë | 14 orë | 1 |
| 8. | Shfmu | Mësimdhënës/e për Histori dhe edukatë qytetare | "Halit Geci" | Llaushë | Zëvendësim | 10 orë | 1 |
| 9. | Shfmu | Mësimdhënës/e për Mësim klasor | "Enver Haliti" | Lubovec | Vend i lirë | Normë e plotë | 1 |

**Kushtet:** Për të gjitha vendet e punës, në të tri nivelet (shkolla fillore, shkolla të mesme të ulëta dhe shkolla të mesme të larta ) kandidatët duhet t'a kenë të kryer fakultetin - drejtimi përkatës sipas Normativit 10/2018, ndërsa në mungesë të kuadrit të kualifikuar vijnë kandidatët e tjerë, të drejtimeve të përafërta, që i plotësojnë kushtet më së miri.
Zgjedhja e kandidatëve për mësimdhënës do të bëhet në bazë të nenit 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, UA 10/2018 si dhe në bazë të rezultateve të panel-intervistës, me shkrim dhe me gojë.
Për Intervistën me gojë dhe me shkrim do të ftohen vetëm kandidatët e listës së ngushtë, sipas nenit 4 të UA 17/2009.
Kandidatët e listës së ngushtë me shkrim dhe me gojë do të ftohen në telefon.

Për konkurrim, kandidatët duhet të plotësojnë dokumentacionin :

- Diploma dhe një kopje e vërtetuar e diplomës;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Vërtetimin për punë nga gjykata;
- Certifikatën e gjendjes shëndetësore (në rast se pranoheni );
- Certifikatë trajnimi - nëse keni ;
- Përvoja e punës - nëse keni ;
- Referencën e punës – ata që kanë përvojë pune;

Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës, kati i parë, sporteli nr. 13;
Kandidatët mund të konkurrojnë më së shumti në dy shkolla;
Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga MASHT.
Fillimi i punës për vendet e lartcekura, nuk do të jetë domosdoshmërisht pas shpalljes se rezultatëve, por varësisht nga vendi i punës në shkollë (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).
Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
Rezultatet e konkursit do të shpallen në webfaqe të Komunës së Skenderajt.
Dokumentacioni nuk kthehet.
Afati i konkursit mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë dhe në webfaqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

Drejtoria Komunale e Arsimit
Skenderaj

K.R.U GJAKOVA 1983

**Kompania Rajonale e Ujësjellësit**
*Regional Water Supply Company*
*Regionalna vodovodna kompanija*

Kompania Rajonale e Ujësjellësit Gjakova,Sh.A , duke u bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), nenit 4 paragrafi 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik shpall :

## K O N K U R S

**Titulli I vendit të punës - Rojtar**
**Numri i pozitave:** 1 (një)
**Kohëzgjatja e punës:** Në kohë të caktuar/ Puna Provuese gjashtë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës/ Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës :**

- Bënë sigurimin e objekteve të Kompanisë dhe hapësirave përreth,
- Ruan automjetet që të mos vijë deri te thyerja e tyre,dëmtimi,vjedhja etj,
- Në raste të vërejtjes së rrezikut nga zjarri apo rreziqeve të tjera ,ndërmerre masat më efikase dhe menjëherë kërkon ndihmë për evitimin e të metave,
- Në raste sulmi ndërmerre masa të caktuara konformë Rregullores mbi punën e Shërbimit në sigurimin fiziko –teknik të objekteve ,
- Të gjitha të metat e vërejtura i shënon në libër të vërejtjeve dhe mbi të njëjtat informon Referentin për mbrojtje dhe siguri fizike,
- Pranimin dhe dorëzimin e detyrës e bënë me shkrim,bartë uniformën dhe armën,
- Përdorë aparatet kundër zjarrit,armën,përdorimi i të cilës në mënyrë precize është përcaktuar në rregullat e shërbimit të rojtarëve dhe udhëzimet e udhëheqësit drejtpërdrejt,
- Punët dhe detyrat e punës i kryen në pajtim me aktet e përgjithshme interno dhe udhëzimeve verbale,
- Bënë kontrollimin e materialit, automjeteve dhe personave të cilët hyjnë dhe dalin në ndërtesë, njëherit në libër shënon hyrjet dhe daljet si dhe vërejtjet e tjera në kohën kur nuk punohet apo jashtë orarit,
- Nuk lejon daljen e automjeteve dhe mjeteve të tjera, nëse për këtë nuk është dhënë urdhri me shkrim apo në mënyrë tjetër, nga oborri apo ndërtesa,
- Shënon kohën e ardhjes dhe daljes së punëtorëve në kohën jashtë orarit të punës,
- Punët dhe detyrat e punës i kryen në katër ndërrime,
- Në rastet e vizitës nga ana e udhëheqësit ose për atë punëtorit të autorizuar, i raporton mbi gjendjen dhe gjërat të vërejtura gjatë punës së tij,
- Si dhe detyrat tjera të cilat (mëtutje) mund të jenë të përshkruara në përshkrimin e bashkangjitur të punës ose të caktuara nga punëdhënësi.

**Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe karakteristikat personale.**

- Kualifikimi - Shkolla e Mesme
- Vet-iniciator/e dhe fleksibil /e në orar të punës.
- Vërtetim nga gjykata që nuk është nën hetime.
- Të ketë aftësi të mira shëndetësore dhe fizike në kryerjen e detyrave të punëtorit fizik

**Paga mujore**: Sipas Rregullores.
**Informata të përgjithshme:**

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

**Procedura për aplikim-** Aplikacioni ( formulari) për konkurrim merret në Kompani dhe në ueb-faqen e Kompanisë, dhe të njëjtës i bashkëngjiten: 1. kopja e letërnjoftimit 2. Certifikata e lindjes, 3. CV-ja 4. Letër Motivuese/ kërkesë për punësim 5. kopjet e dokumentacionit të kualifikimit( kopja e noterizuar), përvojës së punës nëse ka, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit. Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
**Afati i konkurrimit është nga data: 22/09/2020 deri me 06/10/2020**. **Adresa e zyrës** Rr"UÇK"Nr.7,50000-Gjakovë-Kosovë.
**Vërejtje:** Aplikacionet e dërguara me postë, të clat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, ndërsa aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kooperativa Bujqësore "Victoria", me pronar Emrullah Spahiu nga Rahoveci, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810011974, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa Kooperativa Bujqësore "Victoria", sa vllasnikum Emrullah Spahiu nga Rahoveci, donelo odluku o prestani rada sa nr. 810011974, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Kooperativa Bujqësore "Victoria", me pronar Emrullah Spahiu nga Rahoveci has come to the decision to quit its nr. 810011974, the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN
Pranuar më: / Primljeno: 21-09 2020
Njësia / Jedinica: 15-463 | Numri / Broj: 45317 | Shtojca / Dodatak:

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/ 03 Prill 2019, neneve 14 dhe 20 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjës në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtëshme të Komunës e datës 10 gusht 2020, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr-15-463-32604, të datës 30.07.2020 dhe Vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës Nr.15-463-32605, të datës 30.07.2020, në ZK Babush i Muhaxherëve, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, shpallë:

## NJOFTIM PUBLIK
## PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Komuna e Lipjanit në pajtim me Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr-15-463-32604 të datës 30.07.2020 dhe Vendimin për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të komunës në ZK Babush i Muhaxherëve, jep në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, pronat e paluajtshme me shënimet në tabelën si vijon:

| Nr. | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqe për shfrytëzim m$^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00559-4 | Babush i Muhaxherëve | 16132 |
| 2 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00555-2 | Babush i Muhaxherëve | 3868 |

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të cekura më lartë është krijimi i hapësirës për investitorët serioz për investim në biznese prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

**Aplikuesit, në momentin e konkurimit në pajtim me Rregulloren për Taksa Komunale duhet të paguajnë taksën në shumë prej 50 € (pesëdhjetë euro), për çdo parcelë kadastrale të**

*Page 1 of 3*

**ofertuar ndërsa për secilën parcelë nevojitet pliko ose zarfë e veçantë, dhe jashtë kuvertës në njëren anë duhet të shënohet ---- Zona Kadastrale, Babush i Muhaxherëve ----.**

**Njoftohen aplikuesit, se hapja publike e ofertave do të bëhet në ndërtesën e Komunës në Sallën e Kuvendit Komunal me datë: 07.10.2020 duke filluar në ora 14:00.**

### Kriteret për zgjedhjen e ofertave

Zgjedhja e ofertës më të favorshme për Komunën për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret vijuese:

1. Vlera e investimit;
2. Numri i të punësuarve nga investimi;
3. Lloji i investimit që konsiderohet me interes dhe prioritet për komunën;
4. Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës;
5. Qarkullimi bankar për 3 vitet e fundit;

Pjesëmarrësve në konkurim u garantohet e drejta që të:

- Informohen lidhur me procedurat e njoftimit publik;
- Të shohin pronën që do të jetë objekt i dhënies në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionin e pronës;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave

Oferta duhet të përmbajë: shënimet e ofertuesit, numrin e këtij Njoftimi publik, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi pronën për të cilën ofertohet, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik, ndërsa për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik, ndërsa oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vuloset nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale të ofertuar.

Kuverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

**Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit për Njoftimin publik**

*Page 2 of 3*

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli Nr.2 në formën fizike, dhe në formë elektronike nga Uebfaqja e Komunës .

**Aplikacioni bashkë me ofertën në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale dorëzohet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 2 në afat prej 15 ditësh kalendarike nga dita e publikimit të këtij Njoftimi.**

**Ofertat të pakompletuara të paprecizuara, të panënshkruara nuk do të shqyrtohen.**

Gjatë hapjes së ofertave marrin pjesë nënshkruesit e ofertave përkatësisht të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do t'i dërgohet fituesit pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe do të publikohet në Uebfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Informatat shtesë mund të merren në Ndërtesën e Komunës, kati i dytë - zyrët Nr.106 dhe 107 Sektori pronësor-juridik ose në tel 038-200-41-507.

1.Bekim Shabani
2.Nazim Gashi
3.Majlinda Sylejmani
4.Nazmi Krasniqi
5.Denis Gashi

Me datë: 18.09.2020

*Page 3 of 3*

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN
Pranuar më: / Primljeno: 21. 09 2020
Njesia / Jedinica: 4-610 | Numri / Broj: 45473 | Shtojca / Dodatak:

### Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Vllëzërit Frashëri"
Komuna: Lipjan
Data: 22.09.2020

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| ESIP/SDG/025-G/1.6 | Mjete të Konkretizimit për klasat 1-5 |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **SHFMU"Vllëzërit Frashëri", Lipjan.** Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

   **Mjete të konkretizimit për klasat 1-5**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e **SHFMU"Vllëzërit Frashëri" Lipjan,** më së largu deri më **30.09.2020**

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur **Ftesë për ofertë-Mallra,** do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues:
Avdi Azemi
Telefoni: 049 852-692
E-maili: avdiazemi@gmail.com

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr. 1684/20 Pejë, 21.09.2020

Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 102, të Statutit të Universitetit, në mbledhjen e mbajtur me 22.07.2020, dhe në bazë të vendimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Ref. Nr. 710 datë 18.09.2020, miratojë propozimet e njësive akademike për shpalljen e:

**KONKURSIT**
**për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore- Bachelor në vitin akademik 2020/2021**

**I. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

1. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, në vitin e parë të studimeve për vitin akademik **2020/21,** do të regjistrojë **1240** studentë, prej të cilëve **1220** studentë të rregullt dhe **20** studentë me korrespondencë.

2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASh-it, Universiteti do të regjistrojë deri në 12%. Kuota prej 12% e vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale, sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.

3. Në programet që ofrohen në gjuhën boshnjake, 12% e numrit të përgjithshëm sipas pikës 2 do të pranohen kandidatë nga komunitetet tjera jo-shumicë.

4. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASH-i, mund të pranohen edhe kandidatët nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvegja, Maqedonia dhe Shqipëria. Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen nga këto vende do të jetë deri në 5% e numrit të përcaktuar si në paragrafin 1 të pikës I.

5. Përjashtimisht kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2, 3 dhe 4, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.

6. **Mbi bazë të konsideratave humane, Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë rezervon të drejtën e pranimit të kandidatëve me nevoja të veçanta**.

7. Të drejtë pranimi në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.

8. Në Universitet mund të pranohen edhe studentët nga shtetet e tjera, me kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.

9. Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet të verifikohet njohja e institucionit shkollor në bazë të listës së MASHT- it e cila iu dorëzohet të gjitha njësive akademike.

10. Njohja e diplomave për institucionet jashtë Kosovës do të verifikohet në bazë të vendimit për njohje/nostrifikim të diplomave të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Kosovës.

11. Universitet do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklarim, përveç në rastet specifike ku testi do të përgatitet në gjuhën në të cilën zhvillohet programi.

12. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.

13. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklarim, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.

14. **Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UHZ pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve**.

15. **Kandidatët për pranim si student të UHZ-së në vitin akademik 2020/2021 nuk mund të konkurojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.**

**II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE**

1. **Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:**

**a) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:**
Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
- Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.

**b) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:**
Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
- Suksesi në maturë deri në 30 pikë; dhe
- Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.

2. **Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.**

3. **Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.**

